



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 659 datë 3.10.2007

PËR

RREGULLAT E KRYERJES SE PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK ME
MJETE ELEKTRONIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, dhe 75, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendeskryeministrit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullave të prokurimit publik, me mjete elektronike, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen autoritetet kontraktore, të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar , për zbatimin e rregullave të miratuara në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK, ME MJETE
ELEKTRONIKE**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Fusha e Zbatimit

a. Në zbatim të nenit 22 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar, përcaktohen:

i. kërkesat e nevojshme funksionale dhe ligjore, nga autoritetet kontraktore , të përmendura në nenin 36 të ligjit, për kryerjen procedurave të prokurimit, me mjete elektronike;

ii. kërkesat thelbësore teknike, funksionale dhe të sigurisë, që plotësojnë sistemi apo mjetet elektronike, që do të përdoren për kryerjen e prokurimit

b. Këto rregulla nuk zbatohen për veprime të tjera administrative, jashtë sferës së prokurimit publik, në procesin e ankimit administrativ, apo kurdoherë, që sipas ligjit dhe këtyre rregullave, kërkohet përdorimi i dokumentave shkresorë.

2. Me termat e mëposhtëm do të kuptohet:

a) “Ligji për Prokurimin Publik”, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, i cili këtej e tutje do të përdoret LPP.

b) “Rregullat e Prokurimit Publik”, rregullat e miratuara me vendimin nr 1, datë 10.01.2007 të Këshillit të Ministrave “Pë miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që këtej e tutje do të përmenden me RPP.

c) “Mjete Elektronike”, pajisjet elektronike, që do të përdoren për përpunimin dhe ruajtjen (përfshirë edhe përpunimin dixhital) e të dhënave, që transmetohen, jepen dhe merren përmes kabllave, radios, mjeteve optike ose cdo mjeti tjetër elektromagnetik.

ç) “Sistem elektronik prokurimi”, sistemi i integruar i paisjeve elektronike, i përdorur për përpunimin dhe ruajtjen (përfshirë edhe përpunimin dixhital) të të dhënave, që transmetohen në rrugë elektronike, për kryerjen e procedurave të prokurimit.

d) “Nënshkrimi elektronik”, të dhënat e mbledhura në formë elektronike, që gjenden ose kanë lidhje logjike me të dhëna të tjera, po në formë elektronike e që synojnë përcaktimin e origjinalitetit të të dhënave të tyre, si dhe konfirmimin e identitetit të nënshkruesit.

dh) “Nënshkrues”, personi, i cili në emër të tij apo të një personi, fizik a juridik, nënshkruan elektronikisht.

- e) “Çertifikatë elektronike“, vërtetimi elektronik që lidh të dhënat e nënshkrimit elektronik dhe personit përkatës, duke konfirmuar identitetin e këtij personi.
- ë) "Krijimi i nënshkrimit ", *softëare*-i ose *hardëare*-i, i konfiguruar, që përdoret për nënshkrimin elektronik ;
- f) “Autoriteti lëshues”, personi juridik, që lëshon çertifikata elektronike ose siguron shërbime të tjera që kanë lidhje me çertifikatat a me nënshkrimet elektronike.
- g)“Stampimi i kohës”,koha dhe data e përcaktuar në çertifikatën e nënshkruar në formë elektronike, nga personi çertifikues, që e lëshon atë, për përmbajtje të veçantë të të dhënave.
- gj) “Dërgues”, dërguesi i mesazheve elektronike që do të thotë personi/operatori ekonomik që bën dërgesën ose personi, në emër të të cilit është dërguar mesazhi elektronik.
- h) “Adresa”, adresa e mesazhit elektronik, që nënkupton vendndodhjen apo personin, të cilit i dërgohet mesazhi.
- i) “Ndërveprimi”, aftësia e sistemeve të teknologjisë së shkëmbimit të informacionit dhe proceseve të mbështetura prej tyre, për të shkëmbyer informacione ose shërbime, në mënyrë të drejtpërdrejtë e të menjëhershme,, dhe/ose për të funksionuar së bashku në mënyrë efikase.

3. Përdorimi i sistemit elektronik në prokurim

- a) Autoritetet Kontraktore mund të përdorin sistemin elektronik, të ngritur sipas këtyre rregullave, për të kryer të gjitha procedurat e prokurimit, të parashikuara në LPP. Këtu përfshihen si kryerja e procedurës vetëm përmes rrugëve elektronike dhe ajo e ndërthures së formës elektronike me atë shkresore, për disa lloj procedurash, që e kërkojnë këtë.
- b) Sistemi mund të përdoret edhe për të krijuar njoftimet e kontratës dhe të dokumentave të tenderit për procedurat, që do të zhvillohen në formë shkresore. Në këtë rast, kërkesat e parashikuara në shkronjt “e” e “ ë” të pikës 3 të kreut I të RPP-së nuk janë të zbatueshme.
- c) Cdo dokument, që shoqëron ofertën ekonomike, përfshirë edhe ato që lidhen me nenet 45 dhe 46 të LPP, konvertohet në formë elektronike dhe dërgohet po në rrugë elektronike, nëse është e mundur teknikisht, duke përmbushur kështu kërkesat për dokumentacionin shoqërues të ofertës, pa qënë nevoja për t’i dërguar ato në formë shkresore. Në sistemin elektronik dhe në dokumentet e tenderit duhet të jepen të gjitha udhëzimet e nevojshme për mënyrën dhe format e konvertimit të dokumentave.

4. Kërkesat për mjetet e komunikimit

a) Mjetet për të komunikuar përmes rrugëve elektronike dhe karakteristikat e tyre teknike nuk duhet të jenë diskriminuese, si dhe të gjenden lehtësisht e të ndërveprojnë me produktet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, që janë në përdorim të gjerë (neni 36 i LPP-së).

b) Mjetet e komunikimit duhet të jenë të ndërveprueshme, duke siguruar ndërveprimin me pajisjet dhe aplikimet e përdorura gjerësisht dhe duke mundësuar funksionet kryesore të komunikimit dhe të shkëmbimit të të dhënave, me mjetet bazë, që përdoren nga operatorët ekonomikë ose nga publiku i gjerë.

5. Integriteti dhe siguria e të dhënave

a) Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e të dhënave kryhen në mënyrë që të sigurojnë integritetin e tyre dhe konfidencialitetin e ofertave e të kërkesave për pjesëmarrje. Sistemi elektronik i shkëmbimit dhe i ruajtjes së informacionit siguron që autoritetet kontraktore të shqyrtojnë përmbajtjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor për dorëzimin e tyre, sic përcaktohet në LPP dhe në RPP.

b) Kanalet e sigurtë (*https/SSL*) dhe/ose enkriptimi mund të përdoren për të ruajtur integritetin dhe konfidencialitetin e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje. Në çdo rast, në përputhje me parimet e përgjithshme të mos-diskriminimit, disponueshmërisë dhe transparencës, të gjitha palëve të interesuara u vihet në dispozicion një informacion për enkriptimin, me të gjithë informacionin e nevojshëm, të specifikuar, për dorëzimin elektronik të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje.

6. Dokumentimi i të dhënave

a) Sistemi elektronik i mundëson autoritetit kontraktor të dokumentojë ecurinë në procedurat e prokurimit, të kryera me rrugëve elektronike. Kjo kërkesë i referohet çdo faze të procesit të prokurimit, përfshirë edhe fazën kur vihen në dispozicion dokumentat e tenderit.

b) Në mënyrë që të ruhet versionin origjinal i të gjitha dokumentave të shkëmbyera dhe për një regjistrim të saktë të tyre, sistemi duhet të sigurojë funksione të përshtatshme, për çdo provë, që mund të nevojitet, në rast të ndonjë pretendimi.

c) Për të siguruar ofertat/kërkesat deri në orën dhe datën e përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e tyre dhe për të ruajtur të dhënat, nga person të

paaautorizuar, merr rëndësi funksioni i gjurmueshmërisë së veprimeve, përfshirë edhe kohën e datën ekzakte të marrjes në dorëzim të të dhënave.

d) Funksioni i gjurmueshmërisë duhet të mundësojë verifikimin e mesazheve/të dhënave, që janë transmetuar ose janë vënë në dispozicion, emri, kujt i drejtohen, datën, përfshirë edhe kohëzgjatjen e komunikimit. Gjithashtu, duhet të mundësohet ripërcaktimi i radhës së ngjarjeve të ndodhura, përfshirë të gjitha të dhënat e përpunuara elektronikisht ose përllogaritjet automatike, si dhe nëse ka pasur ndërhyrje apo është kompromentuar, në ndonjë mënyrë, sistemi ku kryhet procesi i prokurimit.

II. Njoftimet Dhe Aksesit Elektronik I Dokumentave Të Tenderit

7. Përgatitja dhe Dorëzimi elektronik i njoftimeve

a) Autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen e dokumentave elektronike të tenderit. Në përgatitjen e tyre mbahen parasysh kërkesat përcaktura në RPP, për atë që ato janë të zbatueshme, dhe ku, detyrimisht , përfshihet nxjerja e urdhërit të prokurimit dhe emerimi i anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave. Njësia e prokurimit përgjigjet për hedhjen e të dhënave në sistem, pasi të ketë krijuar *loget* përkatëse.

b) Njoftimet e kontratave, në zbatim të nenit 38 të LPP, i dërgohen sistemit elektronik, Agjencisë së Prokurimit Publik, e cila duhet t'i botojë ato brenda afateve. Njoftimet elektronike të kontratave duhet të përmbajnë së paku, të gjithë informacionin që parashikohen në shkronjën “a” të seksionit 2 të Kreut III të RPP-së. Botimi i njoftimit elektronik të kontratës shmanget detyrimin e botimit të të dhënave në formë të shkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

c) Autoritetet kontraktore, të cilat kanë faqe interneti, krijojnë një seksion, të quajtur “Profili i blerësit”, ku ata mund të botojnë njoftime paraprake, informacione dhe njoftime të tjera, që publikohen edhe nga APP. Profili i blerësit mund të përfshijë edhe informacione për njoftimet e kontratës apo ftesat për ofertë, që janë ende në vazhdim, prokurimet e parashikuara, kontratat e përfunduara, procedurat e anuluarat, si dhe çdo informacion tjetër të dobishëm, të tilla si mënyra e kontaktimit me autoritetin kontraktor etj.

8. Aksesit elektronik në dokumentet e tenderit

Aksesit elektronik në dokumentet e tenderit mund të sigurohet në mënyrat e përcaktuara në njoftim. Për të siguruar akses, të plotë e të pakufizuar, në

dokumentet e tenderit duhet që të gjitha dokumentet përkatëse të jenë në dispozicion, në faqen e internetit, në çdo çast, duke filluar nga data e botimit të njoftimit deri në përfundimin e afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Sistemi bën të mundur dërgimin, me rrugë elektronike, të dokumenteve të tenderit për çdo njoftim të ri kontrate, në rast se operatorët ekonomikë janë të regjistruar në sistem.

III. Kryerja e procedurave përmes sistemit elektronik

9. Dorëzimi në formë elektronike

a) Në procesin e prokurimit publik, me mjete elektronike, sistemi i komunikimit mund të përdoret për të marrë oferta, kërkesa për pjesëmarrje dhe çdo dokument, që lidhet me procesin. Rrjedhimisht, të gjitha kërkesat e përmendura më sipër për përkufizimin dhe përdorimin e mjeteve e të pajisjeve elektronike janë njëlloj të zbatueshme, së bashku me kërkesat e veçanta, që shpjegohen në vijim.

b) Autoriteti kontraktor është i lirë të zgjedhë mjetet e përshtatshme të komunikimit dhe është përgjegjës për organizimin e marrjes së ofertave apo të kërkesave për pjesëmarrje, në mënyrë elektronike, në përputhje me kërkesat ligjore, të parashikuara në këto rregulla. Operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë specifikimet e pajisjes marrëse, për të paraqitur një ofertë të vlefshme.

10. Aksesit në pajisje

Për të garantuar kërkesat për akses, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 36, të LPP-së, kërkesa e parë është sigurimi i specifikimeve të nevojshme, përfshirë enkriptimin për palët e interesuara. Këto specifikime duhet të përshkruhen në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit, duke përfshirë edhe llojin e format, që do të përdoren. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit elektronik, mund të kërkojë një format të veçantë apo që ofertat të strukturohen në një mënyrë të caktuar.

11. Nënshkrimi elektronik dhe siguria e të dhënave

a) Autoriteti lëshues duhet të sigurojë se sistemi për nënshkrimin elektronik plotëson kërkesat e mëposhtme:

- (i) Të dhënat, që përdoren për gjenerimin e nënshkrimit, mund të vihen në përdorim vetëm një herë dhe se fshehtësia e tyre ruhet në mënyrë të kënaqshme;
- (ii) Të dhënat e nënshkrimit nuk tjetërsohen, nëse tregohet kujdes i zakonshëm, dhe se nënshkrimi është i mbrojtur ndaj përvetësimit të paligjshëm;
- (iii) Të dhënat e përdorura për gjenerimin e nënshkrimit mbrohen nga nënshkruesi i ligjshëm, nga përdorimi prej personave të tjerë.

b) Sistemi elektronik, i përdorur për marrjen e ofertave, garanton se nënshkrimi elektronik është në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 36, të LPP-së.

c) Pavarësisht nga sa më lart dhe derisa të miratohet legjislacioni për nënshkrimin elektronik, zgjidhja e përkohshme do të jetë regjistrimi ose pranimi i nënshkrimit të thjeshtë elektronik, i cili përbëhet nga një emërpërdorimi dhe fjalëkalimi unik. Operatori ekonomik i interesuar, kur regjistrohet për herë të parë në sistem, fut të gjitha të dhënat, që i kërkohen, në rrugë elektronike. Të dhënat përpunohen automatikisht nga sistemi, i cili, nëse është e nevojshme, kërkon dërgimin e ndonjë të dhëne të veçantë, në formë shkresore, në autoritetin lëshues, për certifikimin e identitetit të dërguesit të këtyre të dhënave.

ç) Brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 10 ditë, autoriteti lëshues dërgon, në formë shkresore dhe elektronike, emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin për operatorin ekonomik. Këto të dhëna aktivizohen brenda një afati të caktuar dhe mund të ndryshohen në çdo kohë, nga operatori ekonomik. Çdo operator ekonomik, sa herë që do të dorëzojë një ofertë, përdor emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin. Emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi përbëjnë lidhjen logjike, ndërmjet dërguesit të materialit dhe përmbajtjes së këtij materiali, në përputhje me kërkesat e nenit 36, të LPP-së, për përshtatshmërinë e nënshkrimit elektronik.

12. Stampimi i kohës

a) Sistemi garanton stampimin e kohës së saktë të marrjes së dokumentit. Kjo do të thotë se të dhënave u stampohet ora dhe data, të cilat ruhen automatikisht.

Stampimi i kohës kryhet në fillim dhe në fund të çdo dokumenti të marrë.

b) Sistemi duhet të përcaktojë kohën, kur do të trajtohen veprimet e caktuara. Kur mungon ndonjë tregues i veçantë, atëherë transmetimi në fjalë kryhet para skadimit të afatit kohor.

c) Sistemi lëshon, automatikisht, njoftimin për marrjen me sukses të ofertës, e cila dërgohet në adresën elektronike të ofertuesit. Gjithashtu, sistemi mundëson informacionin e mjaftueshëm për ofertuesit, nëse dërgimi elektronik i ofertës së tij ose dorëzimi i saj nuk ka qenë i suksesshëm, veçanërisht në rastet kur zbulohet virus. Në këtë rast vlerësohet se oferta nuk është dorëzuar dhe mundësohet ridorëzimi i saj, me kusht që të mos ketë mbaruar afati kohor i përcaktuar.

13. Aksesit mbi të dhënat (Oferta/Kërkesat) e transmetuara

a) Sistemi, në përputhje me pikën 4, të nenit 22, të LPP-së, duhet të garantojë ruajtjen (mbrojtjen) e të dhënave të transmetuara, përfshirë edhe zbulimin e ndonjë ndërhyrjeje të paautorizuar. Kjo nënkupton se të dhënat e transmetuara merren dhe ruhen automatikisht, pa lejuar që dikush të ketë mundësi të njihet me to, derisa të ketë përfunduar afati kohor për hapjen e tyre. Gjithashtu, sistemi duhet të garantojë se, teknikisht, dokumentohet çdo ndërhyrje në server. Hyrja në sistem dhe të gjitha veprimet e kryera me të dhënat regjistrohen dhe ruhen, për të siguruar gjurmueshmërinë e veprimeve. Para se të hapen të dhënat, sistemi konfirmon se nuk është zbuluar asnjë ndërhyrje e paautorizuar.

b) Sistemi garanton se vetëm personat e autorizuar kanë mundësinë të vendosin ose të ndryshojnë afatet për hapjen e ofertave a të kërkesave për pjesëmarrje, të marra. Siç parashikohet në disa lloje procedurash prokurimi publik, mund të lindë nevoja që të shtyhet hapja e disa pjesëve të caktuara të ofertës. Në këtë rast, sistemi duhet ta mundësojë këtë veprim, pa kompromentuar sigurinë për pjesët e pahapura dhe në përgjithësi, si dhe garanton se ndryshimi i datës nuk sjell pasoja të dëmshme për konfidencialitetin e ofertave.

c) Sistemi garanton që aksesit në ofertat apo kërkesat e dorëzuara bëhet i mundur vetëm përmes veprimeve të njëkohshme nga personat e autorizuar, dhe vetëm pasi të ketë skaduar afati i përcaktuar. Rrjedhimisht, pas marrjes në dorëzim, të dhënat mbeten të aksesueshme vetëm për anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, që duhet të njihen me to.

ç) Anëtarët e komisionit të vlerësimit kanë një çelës individual, kodet e të cilit aktivizohen vetëm pas skadimit të afatit kohor, të përcaktuar për dorëzimin e ofertave. Në datën dhe orën e përcaktuar për hapjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, anëtarët e komisionit, në mënyrë publike, procedojnë me çkodimin e të dhënave, për të siguruar akses, të llojit “vetëm lexim”. Më pas verifikohen certifikimet elektronike dhe konfirmohet integriteti i të dhënave, si dhe kontrollohet nëse dorëzimi i tyre është kryer brenda afatit kohor. Përsa kohë që dokumentet mbahen në sistem, ato mund të kontrollohen sipas skedarit bazë (*master files*).

d) Informacioni i dhënë në nenin 52, të LPP-së, dhe informacioni, që kërkohet të bëhet publik gjatë hapjes publike, mund të vihen në dispozicion, në formë elektronike dhe në kohë reale, për të gjithë ofertuesit, nëse sistemi e mundëson një gjë të tillë. Autoriteti kontraktor duhet të lejojë praninë e ofertuesit të interesuar gjatë fazës së hapjes së ofertës, nëse kërkohet nga ky i fundit, duke përcaktuar në njoftim vendin dhe orën, ku do të kryhet hapja e tyre.

dh) Pas vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor verifikon të gjithë informacionin e paraqitur vetëm për ofertuesit, që përcaktohen në shkronjën “gj”, të pikës 4, të kreut V, të RPP-së, dhe kur vëren pasaktësi apo të dhëna të rreme, zbaton procedurat e parashikuara në nenin 47, të LPP-së.

e) Në mbyllje të procesit, vetë sistemi gjeneron një raport përmbledhës, me të gjitha fazat e procedurës, ku përfshihet, së paku, informacioni i përcaktuar në nenin 12, të LPP-së.

Informacioni i plotë për të gjithë procedurën ruhet nga vetë sistemi, duke krijuar mundësi auditimi, në çdo kohë. Një kopje e këtij raporti mund të printohet dhe ruhet sipas kërkesave të LPP-së dhe legjislacionit në fuqi, për administrimin dhe ruajtjen e dokumenteve zyrtare. Procedurat e prokurimit, të përfunduara, ruhen në sistem dhe janë plotësisht të lejueshme për publikun e gjerë, me përjashtim të informacionit të reverzuar, që cilësohet i tillë në pikën 3, të nenin 21, të LPP-së.

14. Kopja dhe ruajtja e të dhënave

a) Paralel me sistemin elektronik për prokurimin ngrihet dhe funksionon një sistem për kopjimin dhe ruajtjen e të dhënave (*back up*), i cili përfshin një numër masash, për administrimin e këtij procesi.

b) Sistemi *back up* i të dhënave të ruhet në një vend tjetër, jashtë mjediseve, ku është instaluar sistemi elektronik. Sistemi i kopjimit dhe i ruajtjes të së dhënave mbrohet fizikisht dhe i enkriptuar, për të shmangur çdo ndërhyrje.

c) Kopjimi dhe ruajtja e të dhënave bëhen në fillim të çdo ditë pune, në fund të javës dhe në ditën e fundit të punës së muajit dhe kryhen menjëherë pas hapjes publike të ofertave apo kërkesave.

ç) Paralel me sistemin e *back up*, pranë Këshillit të Ministrave instalohet edhe një server i tretë, i cili regjistron të gjitha proceset dhe ndërhyrjet në sistemin e prokurimit elektronik. Në të lejohet të ndërhyhet vetëm në rast të ndonjë pretendimi apo për qëllime auditimi, me udhëzim të veçantë dhe me pjesëmarrjen e më shumë se të një zyrtari, siç përcaktohet në pikën 19.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

15. APP-ja, në zbatim të pikës 11, të këtyre rregullave, do të jetë, derisa ligjet për nënshkrimin elektronik dhe qeverisjen elektronike të përcaktojnë një autoritet tjetër, autoriteti lëshues përgjegjës, për të përmbushur këtë funksion, vetëm për procesin e prokurimit, me mjetet elektronike.

16. APP-ja, për të mbështetur autoritetet kontraktore, krijon dhe mirëmban një sistem dhe faqe të veçantë për prokurimin elektronik, në përputhje me këto rregulla dhe me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, të cilat do të shërbejnë edhe për njoftimet elektronike të kontratave, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 7.

17. Që autoritetet kontraktore të interesuara të mund t'i zhvillojnë prokurimet përmes sistemit elektronik, duhet, paraprakisht, të regjistrohen në këtë sistem.

Çdo autoritet kontraktor i regjistruar duhet të përcaktojë emrat e zyrtarëve përgjegjës, që do të marrin pjesë në procedurat e prokurimit, në mënyrë që APP-ja t'i pajisë me fjalëkalimet përkatëse.

18. Agjencia e Prokurimit Publik miraton rregullat, udhëzimet dhe manualët e përdorimit, të nevojshme, për të vënë në zbatim këto rregulla, si dhe ofron mbështetjen e nevojshme për autoritetet kontraktore apo operatorët ekonomikë, të interesuar.

19. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për funksionimin dhe administrimin e sistemit dhe të ruajtjes të së dhënave. Në udhëzim të përcaktohen kushtet, procedurat për sigurinë dhe mbrojtjen e sistemit, si dhe të sanksionohet se ndërhyrja në sistem bëhet vetëm me *logimin* e njëkohshëm të disa personave, që e kanë këtë akses.

Këtë akses e kanë sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik, drejtori i Agjencisë për Shoqërinë e Informacionit, si dhe një pëfaqësues i zyrës e Avokatit të Prokurimeve Publike.